

# SHËRBESA E NIKODHIMIT TË BERATIT



**Botimet “Trifon Xhagjika”  
Tiranë, 2013**

Përgatiti për botim: **Andrea Llukani**, teolog

Konsulente: **Doc. Holta Sina (Kilica)**

Muzikologe, pedagoge në U.A

## PARATHËNIE

**N**ikodhimi e kishte origjinën nga Vithkuqi i Korçës. Ai banonte në Berat dhe ushtronte mjeshtërinë e rrobaqepësit. Në fillim quhej Nikolla Dede dhe ishte martuar tre herë. Pas vdekjes së gruas së tretë bëri apostazi, sepse kanonet kishtare nuk e lejonin martesën e katërt. Gruan e katërt e kishte myslimane dhe për hir të saj u kthye në fenë islame.<sup>1</sup> Djali i parë, i cili ishte në moshë madhore nuk pranoi të konvertohej, prandaj u largua nga shtëpia dhe u vendos në Malin e Shenjtë. Kur mori vesh që i biri ishte në Malin Athos, Nikollës i lindi dëshira ta takonte. Nikolla vajti në Athos ku ndodhi mrekullia. Pasi pa jetën e murgjve, lutjet, agjërimet dhe shërbesat fetare, u pendua dhe e kuptoi mëkatën që kishte bërë duke mohuar Krishtin. Nikolla vajti në Skitin e Shën Anës, u paraqit tek oshënar Filotheu dhe u bë murg duke marrë emrin Nikodhim. Atje iu përvesh një pendese të tillë sa agjëroi për tre vjet, duke iu lutur Perëndisë. Në Malin Athos, Nikodhimi mësoi se ai njeri që mohonte Krishtin përpara njerëzve mund të falej nga Perëndia vetëm po ta pohonte atë përsëri përpara njerëzve, prandaj i lindi dëshira për t' u kthyer në Berat e të pohonte Krishtin para të gjithëve. Para se të nisej, pati një takim me asketin e dëgjuar të Athosit me oshënarin Akakios Kapsokalivias, të cilit i kërkoi këshilla. Ky e nxiti të kthehej në vendlindje dhe Nikodhimi me shkopin në dorë u nis për në Berat. Me të ardhur në Berat

---

<sup>1</sup>-Anthony Bryer, Kultet e tre shenjtoreve martirë në Shqipëri, 2000 vjet art dhe kulturë kishtare në Shqipëri, Tiranë 2003, faqe 55-57.

njerëzit e njohën dhe meqënëse e kishin marrë vesh me kohë çështjen e rikthimit të tij në krishterim, e denoncuan duke e shpënë te kadiu. Në fillim kadiu u përpoq ta bindte të hiqte dorë nga një akt i tillë, por duke parë këmbënguljen e tij urdhëroi që ta ekzekutonin.<sup>2</sup>

### **Shenjtërimi i Nikodhimit të Beratit**

**N**ikodhimin e dënuan me prerje të kokës më 10 korrik të vitit 1709. Kryeepiskopi i Ohrit Joasaf (1719-1745), i cili ka lindur në Voskopojë mori nismën për të shpallur shenjt Nikodhimin e Beratit. Në vitin 1721 me anën e një dekreti të posaçëm Kryeepiskopi Joasaf shpalli shenjtërimin e Nikodhimit të Beratit, ndërkohë filloi fushatën për popullarizimin e tij. Piktoret Athanas dhe Kostandin Zografi më 1744 pikturuan afreskun e Nikodhimit në kishën e manastirit të Ardenicës dhe në vitin 1762 në kishën e Apostujve të Shenjtë në Vithkuq. Vëllezërit ikonografë të familjes Çetiri e pikturuan Nikodhimin e Beratit në kishën e Nartës, në Vlorë. Tërpo Zografi e ka pikturuar në kishën e manastirit të Shën Naumit më 1806. Gjithashtu në katedralen e Sofjes, Aleksandër Nevski paraqitet Nikodhimi i Beratit me diçidurën “Shenjt Shqiptar”. Në skitin e Shën Anës në Malin Athos gjendet një afresk, i cili e paraqet Nikodhimin duke u paraqitur tek oshënar Filotheu. Afresku është pikturuar nga një piktor anonim dhe daton më 1779. Zakonisht Nikodhimi i Beratit paraqitet bashkë me Shën Naumin, ndërsa në kishën e Apostujve të Shenjtë në Vithkuq të Korçës, që është vendlindja e tij paraqitet i vetëm.<sup>3</sup>

---

<sup>2</sup>-Εὐαγγέλιον Ἁγίου Ἰωάννου τοῦ Θεολογικοῦ, Ἁγία Ὁρθόδοξος Ἐκκλησία, Ἔκδοση 2009, σσ. 164-167.

<sup>3</sup>-Nedai Thëllimi, Një shenjt shqiptar, Tempulli, Nr. 12, Korçë 2007, faqe 107-109.



Nëpërmjet vargjeve të shërbesës autori zbulon ndjenjat e tij patriotike kundër Perandorisë Osmane. Grigori ka shkruar “Gëzohu, o shqiptar i Shqipërisë sonë të dashur, se Shqipëria është krenare për ty”.<sup>8</sup> Gjithashtu tek përleshorja Grigori ka shkruar: “Le të lavdërojmë të gjithë oshënarin dhe dëshmorin Nikodhim, mburrjen e Ilirisë”, ndërsa tek shkurtorja e shërbesës thotë: “Mbrojtësin e mrekullueshëm të Beratit”.<sup>9</sup> Në vitin 1799 Nikodhim Agjioriti botoi Martirologun e Ri me 85 shenjtore që qenë martirizuar në intervalin kohor 1492-1794. Ndërmjet neomartirëve ishte edhe jetëshkrimi i Nikodhimit të Beratit. Gjithashtu në Bibliotekën Kombëtare është në ruajtje “Shërbesë e dëshmorit të oshënuar e të shënjtë të Nikodhimit të Ri”. Nismën për të përkthyer në shqip Shërbesën e Nikodhimit të Beratit e ka ndërmarrë Dhimitër Përmeti,<sup>10</sup> por përkthimi i tij nuk mundi të shohë dritën e botimit. Përkthimi i Dhimitër Përmetit ka qarkulluar dorë më dorë nëpër priftërinjtë e brezave të ndryshëm. Mua ma dërgoi miku im i përkorë atë Petraq Simsia<sup>11</sup> nga Berati. Gjithashtu teologu Dhimitër Beduli<sup>12</sup> ka përkthyer Përleshoren, Shkurtoren dhe Madhërimin e shenjtit.

<sup>8</sup>-Ark. Rest. Gentian Stratobërdha, Shtypshkronja e Voskopojës dhe veprimtaria e saj botuese në nivelet e shtypshkronjave të tjera të Evropës të asaj kohe, Kërkim, Nr. 1, faqe 142.

<sup>9</sup>-Dhimitër Beduli, Shën Nikodhimi i Beratit, Ngjallja, Qershor 1993, faqe 6.

<sup>10</sup>-Dhimitër Përmeti ka qenë drejtor i Seminarit Apostull Pavli deri në vitin 1934. Ai ka botuar disa libra fetarë: Fjala e Mirë, Historia e Dhjatës së Vjetër, (1932), Historia e Dhjatës së Re (1933), Katekizmi i krishterë ortodoks (1933) etj.

<sup>11</sup>-Atë Petraq Simsia ka qenë një ndër nismëtarët e rihapjes së kishës së Shën Spiridhonit në lagjen Goricë të Beratit. Gjatë viteve të diktaturë ai kishte ruajtur kryqin e kishës dhe e dhuroi atë në ditën e rihapjes së kishës, më 22 dhjetor 1990.

<sup>12</sup>-Dhimitër Beduli është specializuar për muzikë bizantine në Besarabi të Rumanisë. Kontributi i Dhimitër Bedulit në fushën e muzikës bizantine është shumë i vyer. Beduli radhitet pas Nolit, përsa i përket kompozimeve dhe përkthimeve të himneve kishtarë.

## Lipsanet e shenjtit

**M**artirizimi i Nikodhimit u bë në fshatin Bubullimë. Në vitin 1762 lipsanet e shenjtit u vendosën në kishën e Shën Marisë në Mangalem. Në kohën e pushtimit fashist italian kisha e Shën Marisë u prish, sepse u zgjerua rruga, prandaj lipsanet e shenjtit i shpunë në kishën e Shën Mëhillit. Pas prishjes së kishave në vitin 1967 lipsani u shpërbë. Eshtrat i morën besimtarët me shpresë se do tu sillnin fat, ndërsa kokën e shenjtit e mori psalti Lili Thimi Koçi<sup>12</sup> dhe e fshehu ne murin e shtëpisë së tij për ta ruajtur nga ndonjë grabitje ose përdhosje e mundshme. Koka e shenjtit ruhet në një kuti prej argjendi, e cila peshon 755 gram. Kutia e argjendtë u gdhend nga argjendarët beratas. Më 10 korrik 1991, i biri i Lili Koçit, Llazari e çmurosi kokën e shenjtit dhe e shpuri në kishë për tu falur besimtarët. Çdo 10 korrik koka e Shën Nikodhimit të Beratit dërgohet në kishën e Shën Mëhillit, prej Llazar Koçit, i cili e ruan me fanatizëm në shtëpinë e tij.<sup>13</sup> Sipas kumtimit gojor të Dr. Thimi Koçit pelegrinë të shumtë vijnë nga Vithkuqi i Korçës, por edhe nga vise të tjera të Shqipërisë për tu falur me shprestari para kokës së shenjtë të Nikodhimit të Beratit.

**Andrea Llukani**

---

<sup>12</sup>-Psalti Ilija Thimi Koçi, më 22 dhjetor 1990 dhuroi ungjillin dhe apostullin me rastin e rihapjes së kishës së Shën Spiridhonit në Lagjen “Goricë” të Beratit.

<sup>13</sup>-Abedin Kaja, Jorgji Bendi, Shën Nikodhimi, shenjt i Beratit, Ngjallja, qershor 2007, faqe 9, 10.





# **SHËRBESA**

**E MARTIRIT OSHËNAR  
NIKODHIMIT**  
që u martirizua në qytetin e Beratit

hartuar nga hieromonaku  
**GRIGOR VOSKOPOJARI**

Voskopojë  
1742

# NË MBRËMËSORE

## THIRRTORET TINGULLIV

**P**ërluftar i Beratit dhe i njëzakonshëm i dëshmorëve, e bashkëndenjësi i engjëjve, le të himnohet tani, me ngazëllim Dëshmori Nikodhim. Shtylla e patundur e besnikëve, shembullor me melodira të shenjta. Pse ky turpëroi, gënjeshtren e ateistëve, dhe zhduku fuqin e demonëve, me fuqinë e Frymës së Hyjëshme. (2 herë)

**A**s zi, as rrezik, as jetë, as vdekje, as plagë dhe të rrahura As' mundën përgjithësisht, që të ndajnë prej dashurisë së krijetarit tënd, o i lumur Nikodhim, fuqin me të vërtetë; por i paluajtur mbete, derisa mbarove luftën o atlet, o i lumur dhe ndenje pranë Zotit i kurorëzuar, o i gjithëlumur. Atë që mohove më parë, tani e dashurove më tepër, duke u bindur hyjnisht fjalëve të etërve, të Athosit o Nikodhim, dhe ike vetë i patundur për atletizëm, dhe mbasi munde të ndyrin trimërisht, veshe kurorën e fitores dhe vallëzon bashkë me martirët, në vallet e shenjtorëve, o i lumur. (2 herë)

**L**e të turpërohen falangat e besëligëve dhe gjindjen ateiste dhe e paligjëshme le të humbë se tani dhe mbledhja e besnikëve të krishterë le të mblidhet mistikërisht, duke kënduar të kremten e përvitëshme të gjithëlumurit, duke thirrur me ngazëllim, me ndërmjetimet e Nikodhimit, o Krisht ruaje trashëgimin tënd.

**S**a mirë i shërbeve si ushtar, Mbretit të fuqive, dhe dorëzove veten o Nikodhim vullnetarisht në thikë, duke ulur qafën tënde. Vajte në vallet e martirëve o i lumur dhe u vlerësive të marësh kurorat e fitores, bashkë me të cilat lutesh tani për ne, o i gjithëhymnuarshëm. Nga Shqipëria lulëzove, o atlet Nikodhim, si trëndafil erëmirë dhe myrëkëndshëm. Dhe kryet e tua të vendosura e të shenjta, si therrrore ia prure Perëndisë. Prandaj u bëre bashkë tëndës e i zakonshëm, në vallet e martirëve o i gjithëlumur, bashkë me të cilët kujto të ndërmjetosh për neve që të hymnojme.

## LAVDI TINGULLI IV

**S**hkëlqeu sot kujtimi yt, shkëlqeve o i lavdëruar, si yll i ndriçëm në dhe të Ilirianëve o atlet Nikodhim. Se duke ngritur mbi supet Kryqin e Krishtit, të cilit ishe i bindur munde gjithë fuqin e djallit dhe pohove Krishtin përpara tiranit, të cilit gënjeshtat prallore ia tregove të kota dhe frikësimet plagët e të rrahurat i mendove për asgjë. Prandaj më në fund u pre me shpatë koka tënde e hyjëshme dhe i kurorëzuar fluturove në qiell ku vallëzon bashkë me engjëjt dhe nërmjeton për ne Krishtin Perëndisë që të shpëtohen shpirtat tanë.

## TANI HYJLINDËSORE

**P**rofiti David që u bë Hyjprind me anën tënde, i parëthiri me melodi për ty atij që të madhështoi, qëndroi Mbretëresha me të djathtë tënde, se Perëndia që denjoi të bëhet njeri prej teje pa Atë të rrëfeu mëmë shkakësore të jetës që të gatoj përsëri koren e tij të prishur prej pasioneve dhe duke gjetur delen e arratisur nëpër malet ta marrë mbi supet e tija e t'ia shpjerë

Atit, dhe me dëshirën e tij ta bashkojë me fuqit qiellore, dhe ta shpëtojë botën o Hyj lindëse, Krishti që ka përdëllimin e madh e të pasur.

## **HYRJA O DRITË GAZMORE**

**O** Jisu Krisht, dritë gazmore e lavdisë së shenjtë të Atit të pavdekshëm qiellor, të shenjtë e të lumtur, si arritëm në perëndimin e diellit dhe pamë dritën e mbrëmjes, himnojmë, Atin, Birin dhe Shpirtin e Shenjtë, Perëndinë. Ti meriton në çdo kohë të himnosh me zëra të mbara o Bir i Perëndisë, që jep jetë; prandaj bota të lavdëron.

Paravargu i mbrëmjes dhe këndimet

## **PASVARGJET NË LITANI. TINGULLI TËRTHOR II**

**E**ni të gjithë besnikë të mblidhemi për të himnuar sot, Nikodhimin Dëshmorin e patundur, sepse ky i largoi të gjitha keqësitat mbi dhe, dhe për asgjë i mendoi. I armatosur me armën e kryqit e pasoi Krishtin dhe kështu u vlerësua që të gëzoj mbretërinë e paanëshme të qiejve, si shërbëtor besëmirë i Perëndisë së Tërëfuqishëm. (2 herë)

**P**randaj i lutemi dhe i thërresim: Nxito o shenjt shpëtona nga çdo lloj nevoje që na vjen nga ngasjet dhe nga dënimi i ardhshëm, me ndërmjetimet e tua të Zotit.

Pastaj bëhet bekimi i bukëve.

## TINGULLI IV

**K**ujtim të përvitshëm, të shenjtë e të veneruar o atlet Nikodhim nderojmë me këngë, psalme e himne në tempullin tënd, duke përqarkuar mendalisht po marrim hirin Hyjnor. Prandaj tani të lavdërojmë, atë që lavdëroje vlerësisht, të cilin ti me nderim e lavdërove, Shpëtimtarin dhe Zotin.

## NË MËNGJESORE

**P**erëndia është Zoti dhe u shfaq ndër ne, i bekuar është ai që vjen në emrin e Zotit (katër herë).

Vargu I: Rrëfehuni te Zoti dhe thirrni emrin e tij të shenjtë.

Vargu II: Të gjithë kombet më rrethuan dhe me emrin e tij i mposhta.

Vargu III: Prej Zotit u bë kjo dhe është e çuditshme në sytë tanë.

## PËRLESHORE

### TINGULLI IV

**I**zbukuruar me stolit e gjakrave të tua, qëndron pranë Zotit, Imbretit dhe Perëndisë, o i gjithëlumur Nikodhim. Prandaj bashkë me vallet e patrupëve e Dëshmorëve këndon me ngazëllim melodinë e veneruar, pra me lutjet e tua shpëtona nga ngasjet.

## **TJETËR PËRLËSHORE** **TINGULLI**

**Sipas: Tis erimu politis**

**L**e të lavdërojmë të gjithë oshënarin dhe dëshmorin Nikodhim, mburrjen e Ilirisë dhe nderin e Athosit, sepse duke mposhtur armikun me asketizëm, lavdëroi Krishtin si një atlet me ndihmën e Virgjëreshës çuditërisht, të cilit le ti thërresim: Lavdi Atij që të fuqizoi, lavdi Atij që të mbajti të paprishur, lipsanin tënd.

LAVDI.....Prapë Përleshore.

TANI.....Hyjlindësore.

**M**isteri i fshehur prej jete dhe i panjohur ndër engjëjtë, u mëçfaq ndër të dheshmit me anën tënde o Hyjlindëse; Perëndia që u mishërua me bashkim të papërzierë dhe denjoi kryq për ne duke dashur, me të cilin ngjalli të paragatuarin dhe shpëtoj prej vdekjes shpirtet tona.

## **NDENJËSORE I** **TINGULLI IV.**

**Pas: Katepllagji Josif**

**L**uftove me kujdes, luftën hyjnore o i urtë dhe u duke fitues në ngasjet e shumëëndura se me shigjetën e kuptuar i armatosur si tjetër goliat, kryetarin e errësirës e godite burrërisht shumë dinakun dhe dole fitues o Nikodhim në rrokjet e tua të padukura. Pra o i gjithëlumur, Krishtit lutu për ne që të hymnojmë.

LAVDI.....Prapë atë.

TANI.....Hyjlindësore.

**U**çuditën o e qashtër gjithë vallet e engjëjve misterin tënd, të lindjes së frikëshme. Qysh ai që përmban të gjitha vetëm me shenjë në krahët e tua si njeri përmbahet dhe mer fillim i parajetëve dhe ushqehet me qumësht ai që ushqen gjithësinë me mirësi të patreguar. Dhe ty si e vërtetë Nënë e Perëndisë, duke himnuar të lavdërojmë.

## **NDENJËSORE II**

### **TINGULLI III.**

**Pas: Tin oreotita**

**M**ë të bukurën bukuri dashurove, dhe bukurit e dukshme nuk i shikove dhe u prire Krishtit si therrorë e panjollëshme. S' u frikësive o Nikodhim prej egërsisë së tiranëve i shkele të gjitha mjeshtërit e dragojt. Prandaj mos mungo të ndërmjetosh për ne, që kremtojmë kujtimin tënd.

LAVDI.....Prapë atë.

TANI.....Hyjlindësore.

**M**e bukurinë e Virgjërisë sate dhe me shkëlqimin e Qashtërsisë sate, Gabrieli u çudit dhe të thërriste o Virgjëreshë. Çfarë lëvdate të të sjell të vyershme dhe si të të quaj nuk e di dhe po shtangem. Prandaj si u madhërova po të thërres gëzohu o Hirëplotë.

## **NDENJËSORE III**

### **TINGULLI TËRTHOR IV.**

**Pas: Tin sofian qe llogon**

**I**forcuar me fuqinë e Krijuesit mendimet dhe pusirat e dinakut, li mposhte o Nikodhim dhe atletizove mbas ligjit, me qëllim o i gjithlumur për lavdi të ardhëshme duke duruar plagë të

tmerëshme të trupit. Prandaj i pasove kryepërësve për të ulur kryet, e për të marrë vdekje për këtë të thërresim; Ndërmjeto tek Krishti Perëndi që tu dhurojë ndjesën e mëkateve atyre që me dëshirë kremtojnë kujtimin tënd të shenjtë.

LAVDI.....Prapë atë.

TANI.....Hyjlindësore.

**K**ujtoj gjyqin e kam frikë, trembem nga hetimi i tmerrshëm, dridhem nga vendimi e frikësohem nga ferri dhembjen e zjarrit, errësirën e tartarit, kërcëllimin e dhëmbëve, krimbin e pafjetur. Mjer çdo bëj kur të vihen fronet, të hapen librat e veprat të kontrollohen. Atëherë o Zonjë bëhu ndihmëse dhe mbrojtëse shumë e nxehtë; se te ty kam shpresë unë shërbëtori yt.

Pastaj psalet:

#### ANTIFONI I TINGULLIT IV.

**Q**ë prej djalërisë sime, shumë pasione më luftojnë. Po ti përkrahmë dhe shpëtomë o Shpëtimtari im. (2 herë)

**J**u që urreni Sionin, kini turp nga Zoti, se do të thaheni si bari prej zjarrit. (2 herë)

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë.

**M**e anën e Shpirtit të Shenjtë, merr jetë çdo shpirt, dhe me pastrim lartësohet, dhe mistikisht ndriçohet prej njësisë trinisore.

Tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.



**M**e anën e Shpirtit të Shenjtë, rrjedhin burimet e hirit që  
vadtën tërë krijesën për rilindje jete.

Paravargu:

**I**çuditshëm Perëndia ndër shenjtorët e Tij, shenjtorët që janë  
lmbi dhe, u bëri çudira.

## UNGJILLI I MËNGJESIT

Psalmi 50 pa zë.

LAVDI.....Me ndërmjetimet e Althoforit.

TANI.....Me ndërmjetimet e Hyjlindëses.

**P**ërdëllemë, o Perëndi, sipas përdëllimit tënd të madh dhe  
sipas dhembshurive të tua të shumta, shuaje paudhësinë  
time. Lajmë krejt prej paudhësisë sime dhe pastromë prej  
mëkatit tim. Se unë e njoh paudhësinë time, dhe mëkati im  
është përpara meje kurdoherë. Te ti vetëm mëkatova dhe të  
keqen e bëra përpara teje, kështu që ti je i drejtë në fjalët e tua  
dhe i kthjellët në gjykimin tënd. Se ja, tek u zura në paudhësi,  
dhe në mëkat më lindi nëna ime. Se ja tek deshe të vërtetën; të  
patreguarat dhe të fshehtat e urtësisë sate m’i tregove.  
Spërkatmë me hisop, dhe do të pastrohem; lajmë dhe do të  
bëhem më i bardhë se dëbora. Bëmë të dëgjoj gëzim e ngazëllim;  
dhe do të gëzohen eshtrat e dobësuarat. Ktheje fytyrën tënde  
nga mëkatet e mia, dhe shuaji gjithë paudhësitë e mia. Krij  
zemër të pastër tek unë, o Perëndi, dhe përtërit frymë të drejtë  
në thellësitë e zemrës sime. Mos më hidh larg fytyrës sate, dhe  
mos e hiq prej meje Shpirtin tënd të Shenjtë. Jepma përsëri  
ngazëllimin e shpëtimit tënd dhe forcomë me frymë sunduese.  
Do t’u mësoj të paudhëve rrugët e tua, dhe të pabesët do të  
kthehen tek Ti. Shpëtomë prej gjakrash, o Perëndi, Perëndia i

shpëtimit tim, gjuha ime do të lavdërojë me gëzim drejtësinë tënde. O Zot, çel buzët e mia, dhe goja ime do të lëçitë lavdinë tënde. Se po të kisha dashur therore, do të kisha prurë; por Ty s' të pëlqejnë therore me djegie të plotë. Therore ndaj Perëndisë është shpirti i dërrmuar; zemrën e dërrmuar e të përlulur Perëndia nuk do ta përbuzë. Bëji të mirë, o Zot, Sionit, sipas mirëdashjes sate; dhe le të ndërtohen muret e Jerusalemit. Atëherë do të të pëlqejnë therore drejtësie, dhurata dhe therore me djegie të plotë. Atëherë do të sjellin viçër mbi altarin tënd.

## TINGULLI TËRTHOR II

**S**ot qyteti i Beratit me rrezet e Althoforit ndriçohet dhe kisha e Perëndisë e zbukuruar me lule, o Nikodhim të thërret: O shërbëtor i Krishtit dhe mbrojtës shumë i nxehtë mos pusho së ndërmjetuari për ne te Zoti.

Pastaj thuhet kanunet.

## SHKURTORJA TINGULLI III I parthenes simeron

**A**rka jote e shenjtë ku lipsani yt ndodhet i hyjshëm dhe i Aveneruar buron pasurisht hirin. Ndriçon fytyrat e atyre që të nderojnë dhe ndjek frymat e ligësisë prandaj të mbledhur nga kjo dëshirë besërisht le ta lavdërojmë.

**TJETËR SHKURTORE**  
**TINGULLI TËRTHOR IV**  
**Sipas: Ti ipermako**

**M**brojtësin e mrekullueshëm të Beratit. Dhe mburrjen e Mskitit së stërgjyshes të Krishtit. Të himnojmë, o oshënar, dëshmor hyjprurës. Si asket dhe si i tillë je dalluar. Dhe si mbrojtës shkumë i gjallë u tregove. Për ne që të thërresim. Gëzohu, o i lumtur Nikodhim.

**SHTËPIA**

**D**uke lënë gjithë kotësinë e ateistëve, Nikodhimi hyjmenjësi dashuroi shumë tregimet e dobishme të etërve oshënarë prandaj u duk ndër të gjithë i veneruar. Sepse ky më parë mohoi Krishtin dhe bie në veprimin e të ligut, pastaj me anën e pendimit ngrihet prapë dhe me të shpejtë shkoi në mal të Athosit dhe duke u bindur në fjalët e etërve prej të cilëve u tregua dëshmor turpëroi besëligjt. Prandaj të gjithë besërisht le ta hymnojmë me lavdi.

**SINAKSARI**

**M**ë 10 të muajit Korrik kremtojmë kujtimin e Dëshmorit Oshënar Nikodhimit të Beratit. Me ndërmjetimet e tij o Krisht Perëndi mëshirona dhe shpëtona. Amin.

**ZBRITËSORET**  
**TINGULLI IV, ANIKSO**

**J**a gojën e çel tani, i frymëzuar prej Shpirtit të Shenjt, dhe këngë do t'i këndo, Nënës së Madhe mbi fron, dhe do ta

kremtoj, me valle buzëqeshur, me zë do t' i shpall kudo, gjithë çudit' e saj.

**O** Zonjë dhe Nën' e Perëndisë, burim i pasosur jetësor, ti siguroi gjith' ata, që të këndojnë plot me zell, dhe lart në qell ku mbretëron, kurorëzoji me çdo lavdi.

**T**i që rri midis lavdisë, përmbi fronin e hyjshëm, nga një re e lehtë, ardhe o Jisu i përjetëshëm, dhe na shpëtove me dorën jetëdhënëse, të thërresim pra: Nder dhe lavdi gjithënjë mbi ty.

**T**ë gjith' i habite ti, me një çudi dhe një lavdi: Ti o Virgjëresh' e pamartuar, Zotin e botës që mbretëron lart në qell, si një bir e mbajte në pëqi, dhe shpëtim që lartazi, u dhurove besnikëve.

**K**ëtë të kremte e lusim sot, për Zonjën edhe Nënë Hyjlindëse, gjithë hyjmëndësit; ejani trokisni pra duartë, dhe lavdëroni Zotin që lindi prej asaj.

**N**uk u faleshin, krijesave hyjmëndësit, po Kryetarit lart, dhe kërcënimin me zjarr, e shkelën me trimëri, psalnin me brohori: Zot lavdi më ty, o Perëndi i Eterve, ti je vetëm i bekuar.

**D**jemat e dënuar për të djegur, prej zjarrit i ka shpëtuar lindj' e Zotit Krisht, si simbol në vjetëri, dhe si një veprim tani, dhe tërë botën po e mbledh për këng' e lavdërim: Himnojeni ju veprat e Zotit, dhe e lartësoni përmbi të gjithë jetët.

**G**jithë njerëzit, kërcenin me ngazëllim, tek drit' e Shpirtit Shenjt, ejani lavdërojeni, engjëj në qiell ejani kremtojeni, këtë të shenjtë panair të Kryezonjës Mari, dhe thërrisni: Ti je më e lumura, Virgjëresh' e kulluar Hyjlindëse.

## MADHËSHTIMET

*Dhiaku del në mesin e derës së bukur dhe thotë:*

**H**yllindësen dhe Mëmën e Dritës duke nderuar me himne le  
ta madhërojmë.

**S**hpirti im madhëron Zotin dhe mendja ime u ngazëllua për  
Perëndinë, Shpëtimtarin tim. Më të nderuarën se Keruvimet  
dhe më të lavdëruarën pa krahasim se Serafimet, që pa u cënuar  
linde Fjalën Perëndi, me të vërtetë Hyjlindësen, ty të  
madhërojmë.

**S**e hodhi sytë mbi pëkulësinë e shërbëtores së tij, se ja që tani  
Se tutje gjithë brezat do të më lumërojnë. Më të nderuarën  
se Keruvimet dhe më të lavdëruarën pa krahasim se Serafimet,  
që pa u cënuar linde Fjalën Perëndi, me të vërtetë Hyjlindësen,  
ty të madhërojmë.

**S**e tek unë bëri vepra madhështore i Fuqishmi dhe i shenjtë  
është emri i tij; dhe predikimi i tij do të jetë brez pas brezi  
për ata që ia kanë frikën. Më të nderuarën se Keruvimet dhe  
më të lavdëruarën pa krahasim se Serafimet, që pa u cënuar  
linde Fjalën Perëndi, me të vërtetë Hyjlindësen, ty të  
madhërojmë.

**R**rëfeu fuqi me krahun e tij; I shpërndau ata që krenohen me  
mendimin e zemrës së tyre. Më të nderuarën se Keruvimet  
dhe më të lavdëruarën pa krahasim se Serafimet, që pa u cënuar  
linde Fjalën Perëndi, me të vërtetë Hyjlindësen, ty të  
madhërojmë.

**P**ërmbysi të fuqishmit prej froneve, dhe i lartësoi të përlulurit, të uriturit i mbushi me të mira, dhe të pasurit i dëboi të zbrazët. Më të nderuarën se Keruvimet dhe më të lavdëruarën pa krahasim se Serafimet, që pa u cënuar linde Fjalën Perëndi, me të vërtetë Hyjlindësen, ty të madhërojmë.

**P**ërkrahu të birin e tij Izrael, duke sjellë ndërmend mëshirën që u premtoi etërve tanë, Avrahamit dhe farës së tij përjetë. Më të nderuarën se Keruvimet dhe më të lavdëruarën pa krahasim se Serafimet, që pa u cënuar linde Fjalën Perëndi, me të vërtetë Hyjlindësen, ty të madhërojmë.

*Këndohet kënga IX e katavasive dhe pas kësaj dhiaku thotë:*

Dhiaku: Përsëri dhe përsëri me paqe le ti lutemi Zotit.

Psaltët: Mëshiro o Zot.

Dhiaku: Përkraina, shpëtona, mëshirona dhe ruajna, o Perëndi me hirin tënd.

Psaltët: Mëshiro o Zot.

Dhiaku: Të tërëshenjtën, të pacënuarën, të përmibekuarën, të lavdëruarën Zonjën tonë Hyjlindëse dhe gjithmonë Virgjërën Mari, bashkë me gjithë shenjtorët, duke kujtuar veten tonë dhe njeri-tjetrin dhe gjithë jetën tonë, Krishtit Perëndisë le t'ia parashtrojmë.

Psaltët: Ty o Zot.

## **DËRGIMSORET TINGULLI III**

**N**ë asketizëm më parë si u ushtrove më mirë në martirizim të dytën si mbarove udhën hyjnore shkove shpejt në qiell dhe bashkë me Krishtin qëndron o Nikodhim i gjithëlavdëruar për ne lutu që të himnojmë nxehtësisht.

**L**avdia e atletëve, dhe shkëlqim i Beratit, o Nikodhim je mbrojtës, i atyre që rrezikojnë. Shpëto prej rreziqesh ata që të himnojnë o i lumur.

**T**ur e endur me ar, qytet i dymbëdhjetmurëshëm, fron që pikon diell, o fron i mbretit, çudi e pakuptuarshme, si i jep qumësht Zotit.

**LAVDËRIMET**  
**TINGULLI TËRTHOR IV**  
**Otu paradhoksu**

**O**dëshmor i Krishtit Nikodhim, ti mbi supet more kryqin e Krishtit, të cilit me shpejtësi i pasove gjurmët. Dhe gjithashtu kënaqësinë e mishit mohove, me shumë trimëri; prandaj për martirizim, vetëdashës rende dhe me rrëket e gjakrave të tu të nderuar, amikun e mbyte. (2 herë)

**O**dëshmor i Krishtit Nikodhim, sado që mohove më parë emrin e Krishtit të veneruar, por prapë të dytën herë, me rrjedhjen e lotëve të tu, atij i rende pranë me shumë shpejtësi duke gjurmuar, atij i solle kryet tënd të veneruar, që tu pre mizorisht, pra të hymnojmë o i lumtur i Krishtit Nikodhim ti fisnikërisht e shpirtit, urtësisht e njohe, dhe nxitove o i lumtur, të nënshtrosh trupin nën shpirtin, dhe djallin, që rrëzoj Evën më parë, këtë e fundose, me rrëket e gjakrave të tu. Prandaj ata që të himnojnë vlerësoi në mbretërinë e Perëndisë.

**P**lagët nuk mundën aspak, as zemërimi i tiranëve, as jetë e kënaqësi, as vdekje e hidhëruar, që të ndajnë ty nga Krishti, por u duke me të vërtetë, shumë i duruar, dhe kështu more prej Perëndisë pasurisht, kurorë të pafishkur, e gëzim të amëshuar, prej këtyre vlerësoi, dhe ata që të hyjnizojnë o Nikodhim i lumtur.

## LAVDI TINGULLI TËRTHOR II

**E**jani o besnikë, të lavdërojmë shpirtërisht me himne atletin  
E ri të Zotit Nikodhimin e gjithëlavdëruar. Sepse ky për  
dashurinë e Krishtit dhe Perëndisë sonë, martirizoi trimërisht  
dhe i veshur me kurorën e mundjes, vallëzon bashkë me martirët  
në tendat qiellore, dhe bashkë me ata ndërmjeton pa pushim  
për ne, që festojmë me besë dhe dëshirë kujtimin e tij kremtëror.

## TANI

**O**Hyjlindëse ti je vresht i vërtetë që mbive pemën e jetës.  
Ty të lutemi o Zonjë ndërmjeto bashkë me Dëshmorin  
dhe gjithë shenjtët të mishërohen shpirtet tona.

## DHOKSOLOGJIA

**L**avdi Perëndisë që është në më të lartat dhe mbi dhenë paqe,  
dhe mbi njerëzit mirëdashje. Të himnojmë, të bekojmë, të  
falemi, të lavdërojmë, Ty të falenderojmë për lavdinë tënde të  
madhe. Zot mbret, Perëndi qiellor, Atë i tërëfuqishëm; Zot Bir  
i vetëmlindur Jisu Krisht, edhe Shpirt i Shenjtë. Zot Perëndi,  
qengj i Perëndisë, Bir i Atit që ngre mëkatën e botës, mëshirona,  
Ti që ngre mëkatet e botës. Prano lutjen tonë, Ti që rri në të  
djathtë të Atit, edhe mëshirona. Se Ti je Shenjt i vetëm, Ti je  
Zot i vetëm, Jisu Krishti, për lavdi të Perëndisë Atit. Amin. Për  
mbrëmje do të të bekoj, dhe do të lavdëroj emrin tënd për jetë,  
e në jetë të jetës. O Zot u bëre streha jonë brez pas brezi, unë  
thashë: O Zot, mëshiromë, shëro shpirtin tim se fajtova tek Ti.  
O Zot, tek Ti gjeta strehë, mësomë të bëj dëshirën tënde se Ti je  
Perëndia im. Se pranë teje është burimi i jetës; me dritën tënde do



të shohim dritë. Zgjate përdëllimin tënd mbi ata që të njohin. Bëna të denjë, o Zot, që të ruhemi këtë natë pa ndonjë mëkat. I bekuar je, o Zot, Perëndi i Etërvë tanë, dhe emri yt është i himnuar dhe i lavdëruar në jetët. Amin. Le të jetë, o Zot, përdëllimi yt mbi ne, sikurse kemi shpresuar tek Ti. I bekuar je, o Zot, mësomë porositë e tua. I bekuar je, o Zot, bëmë të mençëm në porositë e tua. I bekuar je, o i Shenjtë, ndriçomë me porositë e Tua. O Zot, mëshira jote është përjetë, mos i hiq sytë nga veprat e duarve të Tua. Ty të ka hije lëvdata, Ty të ka hije himni, Ty të ka hije lavdia, Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

## APOSTULLI

I drejti do të gëzohet me Zotin. Dëgjoma zërin o Perëndi.  
Prej Letrës II së Palit për Timothënë.

**B**ir Timothe, forcuhu me hirin e Jisu Krishtit, edhe ato që ke dëgjuar prej meje me shumë dëshirë ua dorëzo njerëzve besnikë, të cilët janë të zotët t'ua mësojnë edhe të tjerëve. Edhe duroji të këqijat si ushtar i mirë i Jisu Krishtit. Asnjë njeri, i cili vete ushtar nuk ngatërrohet në andrrallat e jetës, po përpiqet ti pëlqejë gjeneralit të vet. Dhe askush nuk e fiton kurorën e trimërisë veç nëqoftëse trimëron pas ligjës. Bujku, i cili mundohet ka të drejtë të marrë një pjesë të pemëve i pari. Kuptoji ato, që them edhe Zoti të dhëntë mend për të gjitha. Kujtoje Jisu Krishtin prej farës së Davidit, i cili u ngjall së vdekurësh pas Ungjillit tim, për të cilin vuaj të këqija gjer në burg si ndonjë keqbërës po falja e Perëndisë nuk lidhet me vargonj. Prandaj i duroj të gjitha për të zgjedhurit që të gjejnë edhe ata shpëtimin e Jisu Krishtit edhe lavdinë e pasosur.

## UNGJILLI

**Z**oti u tha Dishepujve: Kjo është porosia ime, doni njëri-njëjetrin. Nëqoftëse bota ju urren dijeni se mua më ka urreyer më parë se ju. Sikur të ishit prej botës, bota do tu deshte si të sajte, po meqenëse nuk jeni prej botës, nga e cila ju kam zgjedhur unë, prandaj bota ju urren. Kujtojeni fjalën që ju thashë. Nuk ka shërbëtor më të madh se i Zoti. Ata që më kanë ndjekur mua do tu ndjekin edhe ju. Ata që kanë ruajtur fjalën time, do ta ruajnë edhe tuajën. Edhe këto të gjitha do t'ua bëjnë për emrin tim, se nuk e njohin atë, që më ka dërguar. Sikur të mos kisha ardhur dhe të mos u kisha folur, nuk do të kishin mëkat. Po tani nuk kanë mëhanë për mëkatin e tyre. Ai që më urren mua, urren edhe tim Atë. Sikur të mos kisha bërë përpara tyre veprat, të cilat nuk i ka bërë asnjë tjetër, nuk do të kishin mëkat, po tani edhe i kanë parë veprat edhe më kanë urreyer edhe mua edhe tim Atë. Edhe kështu mbushen fjalët e shkruara në ligjën e atyre që më urreyen darovisht. Edhe kur të vijë Ngushëllimtari, Shpirti i së vërtetës, që dërgohet prej Atit, të cilin do t'ua dërgoj unë me anën e Atit, ai do të dëshmojë për mua. Po edhe ju dëshmoni se keni qenë me mua që në krye. Këto ua thashë që të mos skandalizoheni. Do tu nxjerrin jashtë sinagogave dhe vjen ora në të cilën ata që do tu vrasin do të mburren se i bënë një shërbim Perëndisë.

## MADHËRIMI

**G**ëzohu, o yll i ri i kishës. Lavdi e asketëve, stoli e martirëve. Gëzohu, ti që mban fitoren hyjnore. Nikodhim i trilumur. Gëzohu, atlet i madh.

## KUNGATORJA

I drejti do të kujtohet përjetë.

**CIP Katalogimi në botim BK Tiranë**

Llukani, Andrea  
Shërbesa e Nikodhimit të Beratit/  
Andrea Llukani, Tiranë:  
Botimet “Trifon Xhagjika”, 2013  
28 f, 20 cm.

**ISBN**

